

VENDIM
Nr. 162, datë 19.2.2020

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR HARTIMIN, MIRATIMIN,
RISHIKIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË PAKËSIMIT TË
SHKARKIMEVE NË AJËR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër. Programi kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër është dokumenti kryesor i Republikës së Shqipërisë për të siguruar që angazhimet për pakësimin e shkarkimeve në ajër, për periudhën 2020–2030, të jenë përmbushur.

2. Objektivi i këtij vendimi është mbrojtja dhe arritja e niveleve të cilësisë së ajrit, që nuk sjellin efekte negative thelbësore të rëndësishme në shëndetin e njeriut dhe mjedis, duke përcaktuar angazhime për pakësimin e shkarkimeve antropogjenike atmosferike të dyoksidit të squfurit (SO₂), të oksideve të azotit (NO_x), përbërësve organikë të avullueshëm jometan (NMVOC), amoniakut (NH₃) dhe lëndës së ngurtë pezull (PM_{2,5}). Ky objektiv arrihet nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër të këtyre ndotësve dhe ndotësve të tjerë, të përmendur në aneksin I, të këtij vendimi, si dhe monitorimit e raportimit të ndikimeve të tyre.

3. Ky vendim synon:

a) arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit, të përcaktuar në strategjinë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe në përputhje me udhëzimet për cilësinë e ajrit, të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë;

b) arritjen e objektivave në fushën e biodiversitetit dhe të ekosistemeve, të përcaktuara në strategjinë kombëtare për biodiversitetin;

c) rritjen e sinergjive ndërmjet politikës kombëtare të cilësisë së ajrit dhe politikave të tjera që lidhen me të, veçanërisht politikat e ndryshimeve klimatike dhe energjetike.

4. Objekt i këtij vendimi janë shkarkimet e ndotësve të referuar në aneksin I, që vijnë nga të gjitha burimet e lëvizshme e të palëvizshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të ndotjes.

5. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Angazhim kombëtar për pakësimin e shkarkimeve”, detyrimi për pakësimin e shkarkimeve të një substance; ai specifikon pakësimin e shkarkimeve që, si minimum, duhet të çlirohet në vitin kalendarik të caktuar, si përqindje e totalit të shkarkimeve të çliuara gjatë vitit bazë (2005);

b) “Autoritete kombëtare”, për qëllime të këtij vendimi, ministritë e linjës, së bashku me strukturat e tyre të varësisë, dhe njësitë e qeverisjes vendore;

¹ Ky vendim është përafër me direktivën e BE-së 2016/2284, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 dhjetor 2016, mbi pakësimin e shkarkimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, që amendon direktivën 2003/35/KE dhe që shfuqizon direktivën 2001/81/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L 344/1, 17.12.2016; CELEX:32016L2284.

c) “Cikli i uljes dhe ngritjes”, cikli që përfshin lëvizjen në pistë, në ardhje dhe ikje, ngritjen, ngjitjen, afrimin, uljen dhe të gjitha aktivitetet e tjera të avionëve, që ndodhin nën lartësinë 3 000 këmbë;

ç) “CLRTAP”, Konventa e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP), e ratifikuar me ligjin nr. 9425, datë 6.10.2005, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979 ‘Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët’”;

d) “Dyoksidi i squfurit (SO₂)”, të gjitha komponimet e squfurit, të shprehura si dyoksid squfuri, përfshirë trioksidin e squfurit (SO₃), acidin sulfurik (H₂SO₄) dhe komponimet e reduktuara të squfurit si sulfur hidrogjeni (H₂S), komponime që përmbajnë sulfur dhe sulfure dimetili;

dh) “Karbon i zi (BC)”, lënda e ngurtë karbonike, që thith dritën;

e) “Lënda e ngurtë pezull (PM_{2,5})”, grimcat me diametër aerodinamik të barabartë ose më pak se 2,5 mikrometra (µm);

ë) “Ministria”, ministria përgjegjëse për mjedisin;

f) “Ministri”, ministri që mbulon fushën e mjedisit;

g) “Ministritë e linjës”, për qëllime të këtij vendimi,:

i. ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, zhvillimin urban, transportin dhe industrinë;

ii. ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

iii. ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale;

iv. ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

gj) “Objektivat e cilësisë së ajrit”, vlerat kufi, vlerat e synuara dhe detyrimi për përqendrimin e ekspozimit për cilësinë e ajrit, të përcaktuar në ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, dhe në vendimin nr. 352, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”;

h) “Oksidet e azotit (NO_x)”, oksidi nitrik dhe dyoksidi i azoti, shprehur si dyoksid azoti;

i) “Pararendësit e ozonit”, oksidet e azotit, përbërësit organikë të avullueshëm jometan, metani dhe monoksidi i karbonit;

j) “Përbërësit organikë të avullueshëm jometan (NMVOC)”, të gjithë përbërësit organikë, përveç metanit, të cilët janë në gjendje të prodhojnë oksidantë fotokimikë duke reaguar me oksidet e azotit në prani të dritës së diellit;

k) “Përshtatje”, një ndryshim, rregullim që i bëhet inventarëve kombëtarë vjetorë të shkarkimeve, sipas parashikimeve të kreut IV, të këtij vendimi;

l) “Shkarkim”, shkarkimi i një substance nga një burim i palëvizshëm ose i shpërndarë në atmosferë;

ll) “Shkarkimet antropogjenike”, shkarkimet atmosferike të ndotësve, që lidhen me aktivitetet njerëzore;

m) “Trafik ndërkombëtar detar”, udhëtimet në det dhe në ujërat bregdetare nga anijet e transportit ujor të të gjithë flamujve, me përjashtim të anijeve të peshkimit, që largohen nga territori i një vendi dhe mbërrijnë në territorin e një vendi tjetër;

n) “Zonë e kontrollit të ndotjes”, një zonë detare, që nuk tejkalon 200 milje detare nga vijat bazë, nga të cilat matet gjerësia e territorit detar, e përcaktuar për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes nga anijet, në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare në fuqi.

II. AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR HARTIMIN, MIRATIMIN, RISHIKIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE NË AJËR

1. Ministria është autoriteti kompetent për:

a) koordinimin e përgjithshëm me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, të përfshira në procesin e përgatitjes së programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër;

b) menaxhimin e sistemit të monitorimit dhe të zbatimit të programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër;

c) koordinimin e procesit të përditësimit të programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim;

ç) bashkërendimin e të dhënave të marra nga burime të ndryshme, për të vlerësuar efektet potenciale ndërsektoriale, veçanërisht nga ato burime që gjenerojnë të dhëna (p.sh. përdorimi i energjisë, bujqësia, industria, transporti, sektori rezidencial), që përdoren për përgatitjen e projeksioneve të shkarkimeve të ndotësve, shumë të rëndësishme për efektivitetin e politikave dhe të masave për programin e pakësimit të shkarkimeve të tyre në ajër;

d) përgatitjen e raportit vjetor për zbatimin e programit kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër, mbi bazën e informacionit të dhënë nga ministritë e linjës, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 4, të këtij kreu;

dh) raportimin çdo vit, pranë Këshillit të Ministrave, mbi zbatimin e programit kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës;

e) sigurimin e aksesit në informacion dhe pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit e miratimit të programit kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër dhe për të siguruar shpërndarjen aktive dhe sistematike të informacionit për publikun dhe organizatat e interesuara;

ë) bashkëpunimin dhe bashkërendimin, duke përfshirë dhe shkëmbimin e informacionit me vendet e tjera dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare, në lidhje me kërkimin dhe zhvillimin teknik e shkencor, me qëllim mundësimin e pakësimit të shkarkimeve në ajër;

f) komunikimin me Sekretariatën e Konventës, si Pika Fokale Kombëtare e Konventës për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët (CLRTAP).

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (këtu e në vijim Agjencia), është përgjegjëse për:

a) përgatitjen mbi baza vjetore të inventarëve kombëtarë të shkarkimeve të ndotësve në ajër, të referuar në aneksin I, të këtij vendimi;

b) përgatitjen mbi baza vjetore të raporteve informuese të inventarit të shkarkimeve në ajër;

c) përgatitjen e projeksioneve të shkarkimeve në ajër, duke filluar nga viti 2021;

ç) përgatitjen e inventarëve kombëtarë të shkarkimeve hapësinore të shpërndara dhe inventarëve të burimeve të mëdha pikësore (gridded emission), duke filluar nga viti 2021;

d) raportimin pranë ministrisë të inventarëve, projeksioneve, raportit informues të inventarit të shkarkimeve në ajër, shkarkimeve hapësinore të shpërndara dhe inventarëve të burimeve të mëdha pikësore (gridded emission), sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim;

Për zbatimin e kërkesave të kësaj pike Agjencia mbledh, përpunon dhe menaxhon të dhënat dhe informacionin duke bashkëpunuar ngushtë me:

i. autoritetet kombëtare, sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të kreut I, të këtij vendimi;

ii. institucionet monitoruese, që ofrojnë të dhëna dhe informacione: institute, laboratorë të akredituar, qendra kërkimore dhe shkencore, universitete publike, të kontraktuar nga Agjencia;

iii. përfaqësuesit e industrisë, veçanërisht ata që lidhen me burimet me djegie, si kontribuesit kryesorë të shumë shkarkimeve ndotëse.

3. Ministritë e linjës janë përgjegjëse për:

a) raportimin pranë Agjencisë të informacionit për hartimin e inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe projeksionet e tyre sipas burimeve të shkarkimit, në përputhje me formatet tabelare të përcaktuara nga Agjencia dhe të miratuara nga ministri. Lista indikative e të dhënave kryesore të aktivitetit dhe institucionet përgjegjëse për sigurimin e tyre janë të njëjta me ato të përcaktuara në legjislacionin që rregullon monitorimin dhe raportimin e gazeve me efekt serrë (GES);

b) raportimin pranë ministrisë lidhur me zbatimin e masave të përcaktuara në programet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve në ajër, që lidhen me këto institucione, sipas afateve të përcaktuara në program.

4. INSTAT-i i ofron ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë, sa herë kërkohet prej tyre, të gjitha të dhënat socio-ekonomike të popullsisë dhe të tjera që lidhen me to.

5. Për të mundësuar bashkëpunimin ndërinstitutional që siguron zbatimin e koordinuar të legjislacionit si dhe hartimin e zbatimit të politikave/programeve kombëtare në lidhje me pakësimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, me urdhër të Kryeministrit, me

propozimin e ministrit, ngrihet dhe funksionon Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër (KKAP). Ky komision ka përfaqësues nga ministria dhe strukturat e saj të varësisë, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, përfaqësues të industrisë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit shkencor.

III. ANGAZHIMET KOMBËTARE PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE

1. Shkarkimet antropogjenike atmosferike të dyoksidit të squfurit, oksidet e azotit, përbërësit organikë të avullueshëm jometan, amoniakut dhe lëndës së ngurtë pezull, në Republikën e Shqipërisë, kufizohen në përputhje me angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, që ndërmerren për periudhën 2020–2029 si dhe nga viti 2030 e në vijim, të përcaktuara në aneksin II, të këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.

2. Angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, në aneksin II, të këtij vendimi, propozohen nga ministri përgjegjës për mjedisin, ministri përgjegjës për energjinë dhe transportin, ministri përgjegjës për bujqësinë brenda datës 30 dhjetor 2020. Këto angazhime ndërmerren në përputhje me rezultatet e inventarit të shkarkimeve në ajër për vitin bazë (2005) dhe projeksioneve të shkarkimeve në ajër për periudhën 2020–2030.

3. Pavarësisht afateve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu:

a) Ministria, ministritë e linjës, sipas rastit edhe njësitë e qeverisjes vendore, që veprojnë në zonën që ata mbulojnë, marrin të gjitha masat e nevojshme që synojnë kufizimin në vitin 2025 të shkarkimeve antropogjenike të dyoksidit të squfurit, përbërësve organikë të avullueshëm jometan, amoniakut dhe lëndës së ngurtë pezull. Nivelet indikative të këtyre shkarkimeve përcaktohen nga një trajektore lineare pakësimi, e vendosur midis niveleve të tyre të shkarkimit, të përcaktuara në angazhimet për pakësimin e shkarkimeve për vitin 2020, dhe niveleve të shkarkimit të përcaktuara nga angazhimet për pakësimin e shkarkimeve për vitin 2030;

b) Ministria ndjek një trajektore jolineare të pakësimit, kur është ekonomikisht ose teknikisht më efikase, dhe parashikon që, duke filluar nga viti 2025, trajektorja bashkohet/përputhet në mënyrë progresive me trajektoren e pakësimit linear dhe nuk ndikon në ndonjë angazhim për pakësimin e shkarkimeve për vitin 2030. Ministria, në programin kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër, përcakton trajektoren jolineare të pakësimit dhe arsyet për ndjekjen e saj;

c) kur shkarkimet për vitin 2025 nuk mund të kufizohen në përputhje me trajektoren e përcaktuar të pakësimit, Ministria shpjegon në raportet informuese pasuese të inventarit të shkarkimeve (IIR) arsyet për atë devijim si dhe masat që do të sillnin përsëri në trajektore.

4. Për efekt të përmbushjes së kërkesave të pikave 1 dhe 3, të këtij kreu, nuk llogariten shkarkimet e mëposhtme:

a) shkarkimet e avionëve përtej ciklit të uljes dhe ngritjes së tyre;

b) shkarkimet nga trafiku detar ndërkombëtar;

c) shkarkimet e oksideve të azotit dhe përbërësve organikë të avullueshëm, jometan, nga aktivitetet që ndodhen nën Nomenklaturën për Raportimin 2014 (NFR), siç parashikohet nga Konventa e LRTAP, kategoritë 3B (menaxhimi i plehut organik) dhe 3D (tokat bujqësore).

IV. PËRPUTHSHMËRIA ME ANGAZHIMET KOMBËTARE TË PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE

1. Ministria, në bashkëpunim me Agjencinë, në përputhje me pjesën 4, të aneksit IV, përshtat inventarët kombëtarë vjetorë të shkarkimeve për dyoksidin e squfurit, oksidet e azotit, përbërësit organikë të avullueshëm jometan, amoniakun e lëndës së ngurtë pezull, kur ka mungesë përputhshmërie me angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, si rezultat i aplikimit të metodave të përmirësuara të hartimit të inventarëve të shkarkimeve, të përditësuara në përputhje me njohuritë shkencore.

2. Duke filluar nga viti 2025, në rast se ekzistojnë faktorë thelbësisht të ndryshëm të shkarkimit ose metodologji të ndryshme të përdorura për përcaktimin e shkarkimeve nga kategoritë e burimeve specifike, në krahasim me ato që priteshin si rezultat i zbatimit të një norme apo standardi të caktuar sipas legjislacionit për pakësimin e shkarkimeve në ajër, Ministria

zbaton kushtet shtesë për rregullimet, në përputhje me nënndarjet “ii” dhe “iii”, të shkronjës “d”, të pjesës 4, të aneksit IV, si më poshtë vijon:

a) Pasi të ketë marrë parasysh gjetjet e programit kombëtar të inspektimit dhe zbatimit të ligjit që monitoron efektivitetin e legjislacionit të pakësimit të shkarkimeve në ajër, tregon që faktorët e shkarkimit thelbësisht të ndryshëm nuk vijnë si rezultat i zbatimit të atij legjislacioni;

b) Investigon nëse ka nevojë për veprim të mëtejshëm, në rast të ndryshimeve thelbësore në faktorët e shkarkimit.

3. Nëse në një vit të caktuar, për shkak të një dimri jashtëzakonisht të ftohtë ose të një vere jashtëzakonisht të thatë, nuk sigurohet përputhshmëria me angazhimet për pakësimin e shkarkimeve në ajër, këto angazhime përmbushen duke u bazuar në mesataren e shkarkimeve kombëtare vjetore, të vitit paraardhës dhe atij pasardhës, me kusht që kjo mesatare të mos e tejkalojë angazhimin kombëtar vjetor të pakësimit të nivelit të shkarkimeve në ajër.

4. Nëse në një vit të caktuar, nga zbatimi i të gjitha masave me kosto efektive, një apo më shumë angazhime të pakësimit të shkarkimeve në ajër, të përcaktuar në aneksin II, nuk arrihen, mbasi janë vendosur në një nivel më të rreptë sesa pakësimi me kosto efektive të identifikuar në strategjinë kombëtare për cilësinë e ajrit në mjedis, konsiderohet se janë në përputhje me atë angazhim përkatës të pakësimit të shkarkimeve në ajër për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, me kusht që, për secilin nga ato vite, ai kompenson për atë mospërputhje me një ulje ekuivalente të shkarkimit të një ndotësi tjetër të përmendur në aneksin II.

5. Konsiderohet përputhshmëri me detyrimet, sipas kreut III, të këtij vendimi, për një periudhë maksimale prej 3 (tre) vjetësh, kur mospërputhja me angazhimet për pakësimin e shkarkimeve në ajër për ndotësit përkatës rezulton nga një ndërprerje e papritur dhe e jashtëzakonshme, nga humbja e kapacitetit në furnizimin me energji dhe/ose ngrohje apo ndërprerja e sistemit i prodhimit, i cili nuk ishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme, por me detyrimin që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Të provohet se janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme, duke përfshirë zbatimin e masave dhe të politikave të reja për të siguruar përputhshmërinë, për të shkurtuar sa më shumë që të jetë e mundur periudhën e mospërputhjes;

b) Të provohet se zbatimi i masave dhe i politikave shtesë, nga ato që përmenden në shkronjën “a”, kanë kosto joproporcionale, rrezikojnë në masë të madhe sigurinë kombëtare të energjisë ose paraqesin një rrezik të konsiderueshëm të varfërisë energjetike për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë.

6. Përdorimi i ndonjëres prej përshtatjeve për një vit të caktuar rishikohet dhe vlerësohet nëse plotëson kushtet përkatëse të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij kreu, dhe në pjesën 4, të aneksit IV, ose, kur është e aplikueshme, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në pikat 3, 4 ose 5, të këtij kreu.

7. Në rast se përdorimi i një përshtatjeje të dhënë nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, Ministria, në bashkëpunim me Agjencinë, merr një vendim për raportin përkatës, të përmendur në pikën 6, të kreut VII, që ajo përshtatje nuk pranohet, duke dhënë arsyet e refuzimit. Në rast se nuk ka kundërshtime në raportin përkatës, të përmendur në pikën 4, të kreut VII, përshtatja e përdorur konsiderohet e vlefshme dhe e pranueshme për atë vit.

8. Përdorimi i përshtatjeve, sipas përcaktimit në pikën 6, të këtij kreu, bëhet duke marrë parasysh edhe dokumentet përkatëse udhëzuese, të zhvilluara sipas Konventës së LRTAP.

V. HARTIMI, MIRATIMI DHE RISHIKIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR

1. Për të kufizuar shkarkimet antropogjenike vjetore të dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit, përbërësve organikë të avullueshëm jometan, amoniakut e lëndës së ngurtë pezull, dhe për të kontribuar në arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë vendim, Ministria harton programin kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën 1, të aneksit III, të këtij vendimi, dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave.

2. Gjatë hartimit, miratimit dhe zbatimit të programit të referuar në pikën 1, të këtij kreu, Ministria:

a) vlerëson se deri në çfarë mase burimet kombëtare të shkarkimit mund të kenë ndikim në cilësinë e ajrit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në vendet fqinje, duke përdorur, aty ku është e përshtatshme, të dhënat dhe metodologjitë e zhvilluara nga Programi Evropian i Monitorimit dhe Vlerësimit (EMEP), nën Protokollin e Konventës së LRTAP për financimin afatgjatë të programit të bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e transmetimit në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Evropë;

b) merr parasysh nevojën për të pakësuar shkarkimet e ndotësve të ajrit, me qëllim arritjen e përbushjes së objektivave të cilësisë së ajrit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, aty ku është e përshtatshme, në vendet fqinje;

c) vendos përparësi për masat për pakësimin e shkarkimeve të karbonit të zi gjatë marrjes së masave për të arritur angazhimet kombëtare për pakësimin e lëndës së ngurtë pezull;

ç) koordinon procesin me ministrinë e linjës dhe Komisionin Kombëtar për Ajër të Pastër, që të sigurojë koherencë me planet dhe programet kombëtare të sektorëve kyç, që kontribuojnë në shkarkimet në ajër, duke përfshirë bujqësinë, industrinë dhe transportin;

d) për përbushjen e angazhimeve përkatëse kombëtare për pakësimin e shkarkimeve, përfshin në programin kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër masat e detyrueshme të pakësimit të shkarkimeve, të përcaktuara në pjesën 2, të aneksit III, dhe mund të përfshijë në këtë program edhe masat për pakësimin e shkarkimeve të përcaktuara si opsionale në pjesën 2, të aneksit III, ose masat që kanë efekt zbutës ekuivalent.

3. Programi kombëtar i pakësimit të shkarkimeve në ajër përditësohet, të paktën, një herë në 4 (katër) vjet nga Ministria.

4. Pavarësisht pikës 3, të këtij kreu, politikat e pakësimit të shkarkimeve dhe masat e përfshira në programin kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër përditësohen nga autoritetet kompetente, përgjegjëse për zbatimin e tyre, brenda 18 muajve, nga paraqitja e inventarit të fundit kombëtar të shkarkimeve ose projeksioneve të shkarkimeve kombëtare nëse, sipas të dhënave të paraqitura, detyrimet e përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, nuk janë përbushur ose nëse ekziston rreziku i mospërputhjes.

5. Ministria, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet mjedisore, konsulton me publikun dhe me autoritetet e tjera kompetente, të përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi, draftprogramet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve në ajër si dhe çdo përditësim thelbësor përpara finalizimit të këtyre programeve.

6. Autoritetet kompetente, përgjegjëse për zbatimin e programit kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër, integrojnë në politikat dhe buxhetet e tyre sektoriale aktivitete të tilla, që garantojnë arritjen e angazhimeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër, sipas afateve të përcaktuara në këtë program.

7. Në rastin kur masat e përcaktuara në programin kombëtar të pakësimit të shkarkimeve kanë ndikim ndërkuftar, Ministria kryen konsultime ndërkuftare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për VNM/VSM- të në kontekstin ndërkuftar.

VI. MBËSHTETJA FINANCIARE

1. Autoritetet kompetente, të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi, nxisin zhvillimin e projekteve dhe të programeve lokale e kombëtare, pjesëmarrjen në projekte dhe programe rajonale e ndërkombëtare, që synojnë zbatimin e masave ndërkombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër.

2. Ministria përgjegjëse, që mbulon koordinimin dhe sigurimin e ndihmës së huaj, bashkëpunon me ministrinë dhe ministrinë e linjës për të siguruar financimin e masave të identifikuar në programet ndërkombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër, me qëllim përfitimin nga fondet ndërkombëtare për sektorët kryesorë, që përbushin angazhimet për pakësimin e shkarkimeve, si më poshtë vijon:

a) Prodhimi i energjisë dhe industria (aplikimi i TMD-ve, teknologjitë e pakësimit, vlerat më strikte, kufi, të shkarkimeve, përdorimi i energjisë së rinovueshme etj.);

b) Bujqësia (përmirësimi i strukturës së tokës nëpërmjet inkorporimit të mbetjeve të korrjes, përmirësimi i teknikave për inkorporimin e mbetjeve të korrjes, përmirësimi i gjendjes së lëndës ushqyese dhe strukturës së tokës etj.);

c) Mbetjet (optimizimi i shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, masat për reduktimin e mbetjeve, veçanërisht për mbetjet e biodegradueshme etj.);

ç) Transporti (promovimi i shkarkimit zero, shkarkime të ulëta, automjete me karburant të pastër, alternativ, etj.);

d) Konsumi familjar i lëndës djegëse (masat e efikasitetit të energjisë etj.).

VII. INVENTARËT KOMBËTARË TË SHKARKIMEVE DHE PROJEKSIONET DHE RAPORTET INFORMUESE TË INVENTARIT

1. Hartimi i inventarëve kombëtarë të shkarkimeve antropogjenike të ndotësve në ajër dhe projeksionet e tyre janë bazë për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të programit kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër.

2. Agjencia përgatit dhe përditëson çdo vit:

a) inventarët kombëtarë të shkarkimeve për ndotësit e paraqitur në tabelën A, të aneksit I, për periudhat kohore dhe afatet e raportimit, sipas përcaktimit në këtë tabelë;

b) inventarët kombëtarë të shkarkimeve për ndotësit e paraqitur në tabelën B, të aneksit I, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë tabelë.

3. Agjencia përgatit dhe përditëson çdo 4 (katër) vjet inventarët kombëtarë të shkarkimeve hapësinore të shpërndara dhe inventarët e burimeve të mëdha pikësore, dhe çdo 2 (dy) vjet projeksionet kombëtare të shkarkimeve për ndotësit e paraqitur në tabelën C, të aneksit I, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë tabelë.

4. Agjencia harton një raport informues të inventarit (IIR), i cili shoqëron inventarët kombëtarë të shkarkimeve dhe projeksionet e përmendura në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, në përputhje me kërkesat e paraqitura në tabelën D, të aneksit I.

5. Agjencia, kur zgjedh një përshtatje, sipas kreut IV, të këtij vendimi, përfshin dhe informacionin që tregon se përshtatja e përdorur përmbush kushtet përkatëse të përcaktuara në pikën 1, të kreut IV dhe në pjesën 4, të aneksit IV, ose në pikat 3, 4 ose 5, të kreut IV, kur është e aplikueshme, në raportin e inventarit informues të vitit në fjalë.

6. Inventarët kombëtarë të shkarkimeve (duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, inventarët e përshtatur kombëtarë të shkarkimeve), projeksionet e shkarkimeve kombëtare, inventarët kombëtarë të shkarkimeve të shpërndara hapësinore, inventarët e burimeve të mëdha pikësore dhe raportet shoqëruese të inventarit informues përgatiten dhe përditësohen nga Agjencia në përputhje me parashikimet e aneksit IV.

7. Sektorët, që përfshihen në hartimin e inventarëve dhe projeksioneve të shkarkimeve në ajër, janë:

a) energjia;

b) proceset industriale;

c) bujqësia dhe blegtoaria;

ç) përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (LULUCF);

d) mbetjet;

dh) solventët dhe përdorimi i produkteve të tjera.

8. Referuar pikave 2 dhe 3, të këtij kreu, sistemi i mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave për shkarkimet në ajër, sipas sektorëve përkatës, drejtohet nga Agjencia, në përputhje me përcaktimet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, që krijon Sistemin Kombëtar të Inventarit dhe Projeksioneve për Gazet me Efekt Serrë.

9. Për operatorët e impianteve me djegie, në zbatim të legjislacionit në fuqi, Agjencia:

- a) vendos në kushtet e lejes mjedisore vlerat kufi të shkarkimeve për ndotësit: dyoksidi i squfurit, oksidet e azotit dhe lëndët e ngurta pezull;
- b) vendos në kushtet e lejes mjedisore kërkesa për monitorimin e monoksidit të karbonit;
- c) aplikon vlera kufi të shkarkimeve në afate të ndryshme kohore, në varësi të llojit të impiantit, si më poshtë vijon:
 - i. Për impiantet ekzistuese (5–50 mw): nga data 1 janar 2025;
 - ii. Për impiantet ekzistuese (1–5 mw): nga data 1 janar 2030;
 - iii. Për impiantet e reja, dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- ç) vendos afate të shtyra të pajtueshmërisë me vlerat kufi të shkarkimeve deri në vitin 2030, për disa nga impiantet e mëposhtme:
 - i. Sistemet e ngrohjes qendrore;
 - ii. Impiantet që përdorin biomasën si lëndë djegëse kryesore;
 - iii. Impiantet në sisteme të vogla të izoluara;
 - iv. Impiantet që lidhen me një sistem kombëtar të shpërndarjes së gazit).

VIII. MONITORIMI I NDIKIMEVE TË NDOTJES SË AJRIT

1. Agjencia monitoron ndikimet negative të ndotjes së ajrit në ekosisteme, duke krijuar një rrjet të zonave të monitorimit që është përfaqësues i habitateve të ujërave të tyre të ëmbla, natyrore dhe gjysmënatyrore, dhe të llojeve të ekosistemeve pyjore, duke u bazuar në qasjet kosto-përfitim dhe qasjet në bazë risku.

2. Agjencia koordinon me institucionet monitoruese, që sigurojnë të dhëna dhe informacion, si: institute, laboratorë të akredituar, qendra shkencore e kërkimore, universitete publike, të kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, aty ku është e përshtatshme, për të shfrytëzuar të dhënat e mbledhura në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.

3. Për të vlerësuar ndikimet negative të ndotjes së ajrit në ekosisteme, Agjencia përdor indikatorë të mundshëm monitorimi, të cilët janë listuar në aneksin V. Agjencia, gjatë mbledhjes dhe raportimit të informacionit të listuar në këtë aneks, përdor metodologjitë e përcaktuara në Konventën LRTAP dhe manualët e saj për programet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

IX. RAPORTIMI

1. Programi i parë kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër përgatitet më 1 prill 2022. Programet kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër dhe përditësimi i tyre kryhet në bazë të kërkesave të përcaktuara në kërret III, pika 3, dhe IV, të këtij vendimi.

2. Agjencia, brenda afateve të përcaktuara në pikën 4, të këtij kreu, raporton pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë Evropiane të Mjedisit (AEM) inventarët kombëtarë të shkarkimeve dhe projeksionet, inventarët kombëtarë të shkarkimeve të shpërndara hapësinore, inventarët e burimeve të mëdha të identifikueshme dhe raportet informuese të inventarit, referuar në kreun VII, në përputhje me datat e raportimit të përcaktuara në aneksin I.

Raportimi pranë AEM-së është i njëkohshëm me raportimin në Sekretariatit e Konventës LRTAP.

3. Të dhënat e inventarit kombëtar të shkarkimeve rishikohen nga Qendra e Inventarëve dhe Projektioneve(CEIP) nën Konventën LRTAP, në vitin e parë të raportimit, dhe pas raportimit të parë kryhet në mënyrë të rregullt. Ky shqyrtim përfshin:

- a) kontrollet për të verifikuar transparencën, saktësinë, qëndrueshmërinë, krahasueshmërinë dhe shkallën e plotësimi (TACCC) të informacionit të dorëzuar;
- b) kontrollet për të identifikuar rastet kur të dhënat e inventarit janë përgatitur në një mënyrë që nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Konventën LRTAP;
- c) sipas rastit, llogaritjen e korrigjimeve teknike të identifikuar.

4. Agjencia raporton pranë Agjencisë Evropiane të Mjedisit informacionin e mëposhtëm:

a) Brenda datës 1 korrik 2021 dhe çdo 4 vjet më pas, vendndodhjen e pikave të monitorimit dhe indikatorët që lidhen me monitorimin e ndikimeve të ndotjes së ajrit;

b) Brenda datës 1 korrik 2022 dhe çdo 4 vjet më pas, rezultatet e të dhënave të monitorimit referuar kreut VIII.

5. Ministria raporton pranë Sekretariatit të Konventës, sipas afateve të mëposhtme, për:

a) politikat, strategjitë dhe programet që lidhen me cilësinë e ajrit dhe zbatimin e tyre në afatet e përcaktuara nga vendimet e Konventës;

b) inventarin e shkarkimeve në ajër për të gjithë ndotësit që adresojnë protokollat e Konventës, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, brenda datës 15 shkurt të çdo viti;

c) raportin informues të inventarit të shkarkimeve në ajër (IIR), brenda datës 15 mars të çdo viti;

ç) projeksionet e shkarkimeve në ajër, çdo 4 vjet, duke filluar nga viti 2021, brenda datës 20 mars të këtij viti;

d) shkarkimet sipas rrjetit koordinativ (gridded emission) dhe shkarkimet nga burimet e mëdha industriale, çdo 4 vjet, duke filluar nga data 1 maj e vitit 2021.

X. AKSESI NË INFORMACION

1. Ministria siguron shpërndarjen aktive dhe sistematike të informacionit për publikun, duke e publikuar atë në faqen e saj të internetit, si më poshtë vijon:

a) Programin kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër dhe çdo përditësim të tij;

b) Inventarët kombëtarë të shkarkimeve (duke përfshirë, aty ku është e mundur, inventarët e përshtatur kombëtarë të shkarkimeve), projeksionet e shkarkimeve kombëtare, raportet e inventarit informues dhe raportet dhe informacionet shtesë, në përputhje me kreun VIII.

2. Ministria publikon në faqen e saj të internetit:

a) supozimet kryesore, që janë marrë në konsideratë lidhur me përcaktimin e potencialit kombëtar të pakësimit të shkarkimeve, të përdorura në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit në Mjedis;

b) listën e legjislacionit kombëtar përkatës të pakësimit të shkarkimeve në ajër;

c) rezultatet e kontrollit, të referuara në pikat 1 dhe 2, të kreut VIII.

XI. BASHKËPUNIMI ME VENDET E TJERA DHE KOORDINIMI BRENDA ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

Ministria, sipas rastit, ndjek, pa cenuar nenin 218, të TFEU-së, bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me vendet e tjera dhe koordinimin brenda organizatave përkatëse ndërkombëtare, si Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), UNECE, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO), Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), duke përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me kërkimin teknik e shkencor dhe zhvillimin, me qëllim përmirësimin e bazës për lehtësimin e pakësimit të shkarkimeve.

XII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

